



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**  
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

**OPINION MBI KANDIDATIN ZNJ. ELENA PELUSHI (BAKALLBASHI)**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 pika 2, 54 dhe 55 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- ***Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.***

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim u përcaktua 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë paraqiten kërkesë 6 (gjashtë) prokurorë.

Në datë 13.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë u protokollua kërkesa e prokurores Elena Pelushi (Bakallbashi), e cila aktualisht ushtron funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54 pika 4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës duhet të përgatise një projekt-opinion për çdo kandidat dhe të vlerësoje nëse komandimi është apo jo në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezultoi se:

- Prokurorja Elena Pelushi (Bakallbashi) me Dekretin nr.3108, datë 01.10.2001 të Presidentit të Rrepublicës është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Me Dekretin nr.3474, datë 23.09.2002 të Presidentit të Rrepublicës është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, detyrë të cilën e mban edhe sot. Gjithashtu gjatë karrierës së saj, Znj. Pelushi në vitin 2008 dhe ka mbuluar detyrën e Zv/Drejtuesit të kësaj Prokurorie, nga viti 2008 deri në 2012 ka qenë Drejtuese e kësaj Prokurorie dhe në vitin 2012 përsëri Zv/Drejtuese. Ndër të tjera, prokurorja ka mbuluar edhe detyrën e Prokurorit të Task Forcës nga viti 2012 deri në vitin 2018.
- Në këto kushte për këtë prokurore nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me kriterin e cënimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesi të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë, rezultoi se:

- Nga kthim-përgjigja nr.231/1 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezultoi dakordësia e Drejtuesit të Prokurorisë në lidhje me këtë komandim.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerësoi se komandimi i znj. Elena Pelushi (Bakallbashi) si Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk passjell cënim të interesit më të lartë të Prokurorisë Durrës si dhe nuk cënon funksionalitetin e saj. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerësoi se ngritja dhe funksionimi i ILD, është prioritar.

Në zbatim të nenit 55 pika 2 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr.55, datë 24.02.2020 nisi procedurat për kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës të magistratëve kandidatë për t’u komanduar si Inspektorë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në përmbyllje të procedurës së verifikimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me Vendimin nr.306, datë 29.12.2020, ka vendosur të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidates si dhe lejimin e saj për vijimin e procedurës së komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës duke konsideruar të përmbushura të gjitha fazat e procedurës së komandimit për pozicionin e inspektorit pranë Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

***Miratimin e opinionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për kandidaten prokurore Elena Pelushi (Bakallbashi).***